



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

#### ***Kontrolli i Lartë i Shtetit shpall konkursin për vende të lira pune:***

##### **I. Për 1 (një) vend në pozicionin e Kryeaudituesit në Departament Auditimi.**

##### **-Kërkesat për kandidatët e këtij vendi pune janë:**

- Të kenë kryer arsimin e lartë dhe të jenë diplomuar në master shkencor në Kontabilitet dhe Auditim.
- Të kenë eksperiencë pune mbi 5 vjet në drejtim/administrim në institucione financiare (publike ose private).
- Të zotërojnë certifikata ndërkombëtare Certified Public Accountant (CPA)
- Të zotërojnë gjuhën angleze dhe një gjuhë të dytë të huaj të një prej vendeve të BE-së.
- Të kenë aftësi të mira menaxhuese dhe komunikuese.

Paga mujore për këtë vend pune është në nivelin e pagave të shërbimit civil.

##### **Përshkrimi i punës**

Rakordon punën dhe harton planet mujore të punës, konform detyrave që mbulon, dhe ia paraqet drejtorit të departamentit. Merr pjesë në hartimin e tematikave dhe programeve të auditimit së bashku me përgjegjësit dhe grupet e auditimit. Kontribuon në parashikimin e nivelit të mundshëm të materialitetit e të riskut. Shqyrton materialet e përgatitura dhe dorëzuara nga grupet e auditimit dhe në bashkëpunim me juristin e departamentit jep gjykimin e tij për ecurinë e mëtejshme të auditimit dhe ia paraqet me shkrim drejtorit të departamentit. Në bashkëpunim me drejtorin e departamentit përgatit dhe dorëzon për hartimin e buletineve, raportet e auditimit të evaduar dhe të dhënat statistikore periodike 3-mujore. Mbi bazën e të dhënave të rezultateve të auditimeve ndihmon drejtorin e departamentit në përgatitjen e analizave periodike 3-mujore të departamentit. Evidenton dhe regjistron të dhëna për cilësinë e materialeve të auditimit për çdo auditim të përfunduar dhe evaduar, të cilat ia paraqet drejtorit të departamentit për hartimin e raportit vjetor për vlerësimin e kontrollit të cilësisë. Jep mendime dhe bën propozime për përmirësimin e punës së departamentit, të institucionit dhe propozon për vlerësimin e punës së audituesve.

##### **Paraqitja e dokumenteve**

Kandidatët duhet të paraqesin në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore deri më datë 20 Janar 2017 këto dokumente: Letër motivimi për aplikimin në vendin vakant, CV-në, kopje të diplomës së shkollës së lartë dhe të kualifikimeve pasuniversitare, kopje e listës së notave dhe librezës së punës të gjitha të noterizuara, fotokopje e letërnjoftimit, rekomandime nga punëdhënësit e mëparshëm, dëshmi penaliteti, dokumente të tjera (nëse ka), që i çmon se mund t'i vlejnjë për vlerësimin e përgatitjes arsimore dhe profesionale, si dhe dëshmi të zotërimit të gjuhëve të huaja.

##### **Konkurrimi**

Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për Kushtetutën, ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ligjin nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", "Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH", "Standardet e kontrollit të KLSH" dhe "Standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, mbi njohuritë dhe të dhënat që jepen në serinë e botimeve të KLSH-së 2012-2016, si dhe në faqen zyrtare të KLSH-së në internet".

Në faqen zyrtare të Kontrollit të Lartë të Shtetit [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al), më datë 21 Janar 2017 do të shpallet lista e verifikimit paraprak të kandidatëve, si dhe datat e zhvillimit të konkurrimit.

**Kontrolli i Lartë i Shtetit**